



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 7E5/4 prot.

Tiranë më 31.05.2018

**VENDIM**

Nr. 22, datë 31.05.2018

**MBI**

**ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31/1, a/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k,

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr.128 datë 26.04.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në datë 27.04.2018 filloi hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k., me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Shoqëria "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k. dhe verifikimin e Rekomandimit Nr.18/3 datë 17.11.2010.

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k., është kontrollues i cili mbledh dhe përpunon të dhëna personale të kategorive "punonjës" dhe "klientë".

Kontrolluesi "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k., është subjekt tregtar juridik, me NIPT: J61901061H, me objekt të aktivitetit: Prodhimin, ambalazhimin, shpërndarjen dhe

shitjen e pijeve jo alkolike të prodhuara në çfarëdo shoqërie brenda dhe jashtë Shqipërisë. Studime, kërkime, konsulentë e projektim në sektorët e përmendur më lart, etj.

Në fillim të kontrollit, kontrolluesi "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k., u shpreh, se shumica e administratës së tij, ishin me pushimet vjetore dhe për pasojë nuk ishin disponibël për të siguruar dokumentacionin e kërkuar nga grupi i kontrollit, dhe për këtë arsye, u dakordua data 10.05.2018, si datë për të vazhduar hetimin nga ana e grupit të kontrollit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, në datë 10.05.2018 u hartua procesverbali i mbajtur për këtë qëllim, i cili u lexua në prani të palëve, me konstatimet e mëposhtme:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi ka hartuar rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të Vendimit Nr. 6, të Komisionerit, datë 05.08.2013, për "Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".
4. Kontrolluesi në kontratat me të tretë, me objekt: ofrimin e shërbimeve postare, parashikon në parim detyrimin për ruajtjen të konfidencialitetit, por këto kontrata nuk janë hartuar sipas Aneksit Nr.1 të Udhëzimit Nr.19 të Komisionerit, datë 03.08.2012, mbi "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi".

Në përfundim të kontrollit, përfaqësuesi i kontrolluesit "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k., kërkoi një afat pesë (5) ditor për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me procesverbalin.

-Konstatimi i pikës 3 të procesverbalit përbën shkelje të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, i cili shprehet: "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj. Çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit, nuk duhet t'i përpunojë të dhënat personale, tek të cilat ka akses, pa autorizimin e kontrolluesit, përveçse kur detyrohet me ligj".

-Konstatimi i pikës 4 të procesverbalit përbën shkelje të nenit 20 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, i cili në pikën 2 të tij, shprehet:



*"2.Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e shkruar të kontrolluesit me përpunuesin".*

Në datë 15.05.2018, përfaqësuesi i kontrolluesit "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k., paraqiti procesverbalin e firmosur nga ana e kontrolluesit, duke u shprehur si më poshtë:

*"Në lidhje me pikën 3, 4 sot në datë 15.05.2018, dorëzojmë deklaratën e konfidencialitetit për personat që bëjnë përpunim të dhënash, sipas ligjeve. Pra kemi përmbushur menjëherë këtë detyrim ligjor.*

*Për sa i përket pikës 4, dorëzojmë marrëveshjet e konfidencialitetit me shoqëritë "Pelikan" sh.p.k., "Green Recycling" sh.p.k., "Kristal Communication" sh.p.k. "*

Dokumentacioni i paraqitur nga përfaqësuesi i kontrolluesit në datë 15.05.2018, u administrua në cilësinë e provës materiale.

Në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", më datë 23.05.2018, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimin e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit u shpreh:

- Kemi përmbushur detyrimet ligjore sa i përket shkeljeve të konstatuara nga grupi i kontrollit.
- Dokumentacioni i paraqitur nga përfaqësuesi i kontrolluesit në këtë seancë, u administrua në cilësinë e provës materiale, pasi vërtetonte përmbushjen e konstatimeve të procesverbalit, mbajtur nga grupi i kontrollit, dhe nënshkruar nga palët.

Në lidhje me pretendimet e kontrolluesit, Zyra e Komisionerit bën me dije se:

Shkeljet e konstatuara si pasojë e moszbatimit të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet e tjera nënligjore, konsistojnë në moszbatimin e parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe cenimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysht faktin se kontrolluesi ka rikuperuar shkeljet e konstatuara, ka përmbushur rekomandimet e Komisionerit sipas aktit rekomandues të tij, Nr.18/3 datë 17.11.2010, por shkelje të tilla në kushtet kur kontrolluesi ka dijeni për ligjin, janë të ndëshkueshme pasi lidhen me sigurinë e të dhënave personale dhe parimet bazë të mbrojtjes së tyre.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit çmon vendosjen e sanksionit, për kundërvajtjen administrative të nenit 20/2 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, e cila në referim të nenit 39/1, germa "ç" sanksionohet me gjobë, si më poshtë:

- "ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;"

Kontrolluesi, "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k., në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 20/2, dhe 39.1 shkronja "ç" të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

### V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit "Coca Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k., me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 31.05.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

